



BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Në bazë të nenit 47 paragrafi 1 pika 6 të Ligjit për Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/2010) dhe neni 28 paragrafi 4 të Ligjit për mbrojtjen e konsumatorëve gjatë marrëveshjeve për kredi konsumatore ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 51/2011), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë miratoi

VENDIM

për njoftimin e numrit dhe vlerën e marrëveshjeve të lidhura të kredisë konsumatore dhe normës vjetore të rënë dakord të kostove totale

(„Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 91/2011)

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Me këtë vendim përcaktohet forma, përmbajtja, mënyra dhe afatet sipas të cilave banka është e obliguar deri te Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë (në tekstin e mëtejshëm: Banka Popullore) të dorëzojë raport për numrin dhe vlerën e marrëveshjeve të lidhura të kredisë konsumatore dhe për normën vjetore të dakorduar të kostove totale (SVT).

II. RAPORT PËR NUMRIN DHE VLERËN E MARRËVESHJEVE TË LIDHURA PËR KREDI KONSUMATORE DHE PËR NORMËN VJETOR TË DAKORDUAR TË KOSTOVE TOTALE (SVT)

2. Banka është e detyruar deri te Banka Popullore të dorëzojë raport për numrin dhe vlerën e marrëveshjeve të lidhura për kredinë konsumatore dhe për normën vjetore të dakorduar të kostove totale (formulari 1) në bazë gjysmëvjetore.

Formulari 1 është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

3. Gjatë plotësimit të Raportit nga pika 2 e këtij vendimi zbatohen rregullat e mëposhtme:

a) Në kolonat numër 3 dhe 4 shënohen:

- normat mesatare vjetore të ponderuara të kostove totale, për llojet e kredive që tregohen në kolonën numër 2 në rreshtat 1, 2, 3, 4 dhe 5, të ndara sipas maturimit të kredisë, dhe
- normat mesatare vjetore të ponderuara të interesit për kreditë në rreshtat 6 dhe 7, pjesëtuar sipas maturitetit.

Për nevojat e kredive të ponderuara nga rreshtat 1, 2, 3, 4 dhe 5, përdoret SVT e përcaktuar fillimisht dhe shuma e marrëveshjeve të lidhura të kredisë në periudhën gjashtëmujore raportuese.

Për nevojat e kredive të ponderuara të treguara në rreshtin 6 dhe 7, përdoret norma e interesit e dakorduar dhe shuma e kredive të përcaktuara në marrëveshjet e lidhura për lëshimin e kartelave kreditore dhe marrëveshjet për mbitërheqjen e lejuar në periudhën gjashtëmujore raportuese.

Në kolonën numër 3 shënohen kreditë e miratuara me maturim të dakorduar deri në 1 vit, ndërsa në kolonën numër 4 shënohen kreditë e miratuara me maturim të dakorduar mbi 1 vit.

b) Në kolonën numër 5 shënohet numri i marrëveshjeve të kredisë konsumatore, gjegjësisht marrëveshjet për lëshimin e kartelave të kreditit dhe marrëveshjet për mbitërheqjet e lejuara, të cilat janë lidhur në periudhën gjashtëmuajore raportuese.

c) Në kolonën numër 6 shënohen:

- vlerën e kredive nga reshtat 1, 2, 3, 4 dhe 5, për periudhën raportuese, dhe
- vlerën e marrëveshjeve të lidhura për kredi në bazë të kartelave të kreditit të lëshuara dhe marrëveshjet për mbitërheqjen e lejuar nga reshtat 6 dhe 7 për periudhën raportuese.

ç) Në rreshtin numër I shënohet numri total i kontratave të lidhura në periudhën raportuese.

d) Në rreshtin numër II shënohet vlera totale e kontratave të lidhura për periudhën raportuese.

4. Afati për dorëzimin e Raportit nga pika 2 e këtij vendimi është 60 ditë pas përfundimit të periudhës raportuese.
5. Banka detyrohet të përgatisë raportin e parë nga pika 2 e këtij vendimi me gjendjen e datës 31.12.2011 dhe ta dorëzojë në Bankën Popullore më së voni në afatin e përcaktuar në pikën 4 të këtij vendimi.

III. DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

6. Dispozitat e këtij vendimi që u referohen bankave zbatohen edhe për kursimoret dhe filialet e bankave të huaja në Republikën e Maqedonisë.
7. Me fillimin e zbatimit të këtij vendimi, pushon të vlejë vendimi për njoftimin e numrit të marrëveshjeve të lidhura për kredi dhe normës vjetore të dakorduar të kostove totale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 42/2011).
8. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e publikimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", dhe do të fillojë të zbatohet nga 01.10.2011.

O nr. 02-15/VII-2/2011
30.06.2011
Shkup

Guvernator
dhe kryesues
i Këshillit të Bankës Popullore të
Republikës së Maqedonisë
Димитар Богов